



Prishtinë, 13 prill 2017
Kodi i ZRRE-së: V_910_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Dispozitat Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Neni 25 dhe Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e nenit 39 dhe nenit 40 paragrafi 2 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085; dhe
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 2 Neni 6 Neni 7, Nenin 9, Nenin 10 dhe Nenin 11 të Rregullës për Zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit,

në seancën e mbajtur më 13 prill 2017 nxori këtë:


V E N D I M


PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË TENDERIMIT PËR ZGJEDHJEN E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT

- I. **SHPALLET** Tenderi për zgjedhjen e Furnizuesit të mundësisë së fundit.
- II. Furnizuesit që aplikojnë për të ofertuar në procedurën e tenderimit duhet të demonstrojnë se përmbushin kriteret e dhëna në nenin 4 të Rregullës për furnizuesin e mundësisë së fundit..
- III. Furnizuesi i mundësisë së fundit do të jetë i obliguar që të siguroj të gjitha shërbimet e furnizimit ashtu siç janë të përcaktuara në Ligjin për Energjinë Elektrike, Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe në licencën përkatëse të lëshuar nga Rregullatori.
- IV. Furnizuesi i mundësisë së fundit do të caktohet për një periudhë veprimi si furnizues i tillë prej tre (3) vitesh.
- V. Furnizuesi i mundësisë së fundit do të zgjidhet furnizuesi i cili ofron Koston më të ulët Direkte me Pakicë të Furnizimit me energji elektrike, siç është definuar në Rregullën për furnizuesin e mundësisë së fundit.
- VI. Furnizuesi i mundësisë së fundit do të furnizoj konsumatorët që ngelin pa furnizues në rast kur:
 - Furnizuesi i tyre ka bankrotuar apo është në procedurë të likuidimit;
 - Licenca e furnizuesit të mëparshëm është revokuar përkohësisht ose në mënyrë të përhershme, ose ka pushuar së vlefturi (skaduar); dhe
 - Konsumatori ka dështuar në zgjedhjen e furnizuesit të ri pas ndërprerjes së kontratës me furnizuesin e mëparshëm.

- VII. Konsumatorët e referuar në dispozitivin nën pikën VI të këtij vendimi kanë të drejtë të shërbehen nga Furnizuesi i mundësisë së fundit për një periudhë jo më shumë se gjashtëdhjetë (60) ditë.
- VIII. Furnizuesi i mundësisë së fundit do të filloj furnizimin me energji elektrike me ndërprerjen e kontratës të konsumatorit me furnizuesin e mëparshëm ose kur furnizimi fillon për konsumatorin e ri, por që kontrata nuk është nënshkruar me ndonjë furnizues tjetër.
- IX. Konsumatori i cili do të furnizohet me energji elektrike nga Furnizuesi i mundësisë së fundit, nëse dështon të hyj në marrëveshje me furnizuesin e ri brenda periudhës së përcaktuar në pikën VII të dispozitivit të këtij vendimi, operatori i sistemit do të ndërpres furnizimin me energji elektrike.
- X. Procedura e Tenderimit për zgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit do të udhëhiqet nga Rregullatori.
- XI. Njoftimi për të dorëzuar ofertat për tenderim nuk do të jetë më i shkurt se tridhjetë (30) ditë nga data e publikimit.
- XII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- XIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i Rregullatorit:


Krenar Bujupi, u.d. Kryesues


Arsim Janova, anëtar


Besim Sejfi, anëtar